



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 93, datë 30.06.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “FOND PENSIONI ME  
PJESËMARRJE TË HAPUR MASTER PENSION FUND”, KONTRATËS TIP  
INDIVIDUALE PËR ANËTARËSIMIN NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT,  
KONTRATËS TIP MIDIS PUNËDHËNËSIT DHE SHOQËRISË ADMINISTRUESE  
PËR ANËTARËSIMIN E PUNËMARRËSVE TË TIJ NË FONDIN E PENSIONIT  
PRIVAT, DEKLARATËS TIP TË PRANIMIT TË PJESËMARRJES SË  
PUNËMARRËSIT NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT SI DHE PROSPEKTIT,  
ADMINISTRUAR NGA “CREDINS INVEST” - SHOQËRI ADMINISTRUESE E  
FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE  
KOLEKTIVE SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 76/2023, datë 21.09.2023, “Për fondet e pensionit privat”, Rregullores nr. 1, datë 31.01.2024, “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Rregullores nr. 2, datë 31.01.2024, “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e fondit të pensionit privat “Fond Pensioni me pjesëmarrje të hapur Master Pension Fund”, miratimin e kontratës tip individuale për anëtarësimin në fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Master Pension Fund, kontratës tip midis punëdhënësit dhe shoqërisë administruese për anëtarësimin e punëmarrësve të tij në fondin e pensionit privat me pjesëmarrje të hapur Master Pension Fund, deklaratës tip të pranimit të pjesëmarrjes së punëmarrësit në fondin e pensionit**

privat me pjesëmarrje të hapur Master Pension Fund, të përzgjedhur nga punëdhënësi dhe miratimin e prospektit, të administruar nga “Credins Invest” - shoqëri administruese e fondeve të pensionit privat dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive sh.a.

2. Ngarkohen Drejtoria e Licencimit dhe Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Mimoza KAÇI**